



Data	
Nr. Prot	

RELACION

VENDIMI

PËR

SHOYRTIMIN E REZULTATIT TË VERIFIKIMIT TË PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM PËR SUBJEKTIN VETËDEKLARUES Z. ERIN PJETER GJONI, ANËTAR NË KËSHILLIN E BASHKISË LEZHË, I PROPOZUAR NGA SUBJEKTI ZGJEDHOR “PARTIA SOCIALDEMOKRATE”, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023

I. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ushtron në emër të KQZ-së kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta, si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ia njeh shprehimisht Rregullatorit ose KAS-it.

Duke vlerësuar nga pikëpamja e objekti që trajton ky projektvendim, vlerësohet nga ana e ligjshmërisë se është në kompetencë të Komisionerit për ta shqyrtuar.

II. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin për funksionet publike si dhe përpunimin për formularin e vetëdeklarimit për disa subjekte ndër të cilat është edhe “Anëtari në Këshillin e Bashkisë”.

Z. Erin Pjeter Gjoni, është propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialdemokrate” si kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Lezhë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

Për këtë kandidat më datë 19.3.2023, pranë KQZ është depozituar formulari i vetëdeklarimit i cili është regjistruar me nr. unik LE-PSD 4943. Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të z. Erin Pjeter Gjoni, rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015.

Në kuadër të verifikimit paraprak të kushteve të kandidimit të këtij kandidati, sipas përcaktimit të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, si dhe vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit:

- a) Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, nëpërmjet komunikimit në rrugë elektronike, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, e cila nga ana e saj informon Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, se subjekti vetëdeklarues z. Erin Pjeter Gjoni, rezulton të jetë i rehabilituar në bazë të nenit 69 të Kodit Penal.
- b) Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, nëpërmjet komunikimit në rrugë elektronike, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile, e cila nga ana e saj informon Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, se subjekti vetëdeklarues z. Erin Pjeter Gjoni, nuk ka ndryshime në përbërësit e gjendjes civile.

II

Pasi është konstatuar që kandidati nuk është në kushtet e ndalimit për të kandiduar, janë verifikuar të dhëna të tjera në formularin e vetëdeklarimit të z. Erin Pjeter Gjoni, ku rezultoi se ka deklaruar:

- Në rubrikën III. “TË DHËNA MBI GJENDJEN GJYQËSORE TË PERSONIT”, të Formularit të Vetëdeklarimit,
- *Pyetjes 1* “A jeni dënuar ndonjëherë me vendim gjyqësor të formës së prerë nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj?” subjekti i vetëdeklarimit është përgjigjur “PO”,
 1. Gjykata Shkodër me vendimin nr. 74, datë 01.03.2010 e ka dënuar me 2 (dy) vite shërbim prove për veprën penale të parashikuar nga neni 186/1 dhe 291,
 2. Alba, Itali me vendimin nr. 345/11, datë 27.09.2011, ka vendosur pezullim burgimi për veprën penale të parashikuar në nenin 163 SS CP,
 3. Mal i Zi është dënuar me gjobë 300(treqind) euro në Dhjetor 2017, pa përcaktuar veprën penale;
- *Pyetjes 3* “A keni qenë ndonjëherë në hetim ose gjykim nga një autoritet i huaj, për kryerjen e një vepre penale?” subjekti i vetëdeklarimit është përgjigjur “PO”,
 1. Prokuroria Alba Itali, në shtator 2011, dënuar me pezullim burgimi,
 2. Prokuroria Mal i Zi, në dhjetor 2017, dënuar me gjobë 300(treqind) euro;
- *Pyetjes 4* “A keni qenë ndonjëherë i ndaluar apo i arrestuar nga organet ligjzbatuese, për kryerjen e një vepre penale?” subjekti i vetëdeklarimit është përgjigjur “PO”

1. Prokuroria Shkodër në vitin 2011, i dyshuar për veprën penale të parashikuar nga neni 186/1 dhe 291,
 2. Prokuroria Alba, në Bra Itali në korrik 2011, i dyshuar për ngatërresë,
 3. Policia kufitare Malin e Zi për në Dhjetor 2017, i dyshuar për vullë fallco;
- *Pyetjes 8* “A keni jetuar ndonjëherë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për më shumë se 1 muaj?”, subjekti i vetëdeklarimit është përgjigjur “PO”; Subjekti vetëdeklarues ka qënë emigrant në Cuneo, Itali në vitin 2011.

Nga konstatimet e mësipërme Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me shkresën nr.4998., datë 11.05.2023, vendosi t’ia kalojë rastin për verifikim të thelluar Prokurorisë së Përgjithshme, si institucioni kompetent që kryen verifikimin e plotë të deklarimeve të bëra.

Me shkresën nr. 612/41 prot.extra 23, datë 11.09.2024, Drejtoria e Koordinimit Institucional, Sektori i Dekriminalizimit pranë Prokurorisë së Përgjithshme, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, vendimin “Për miratimin e rezultatit të verifikimit për subjektin z. *Erin Pjeter Gjoni*”, Prokuroria e Përgjithshme, pas kryerjes së gjithë verifikimeve përkatëse, i konsideron këto të fundit të plota dhe të bazuara në nenin 8, pikat 1 dhe 2, të lidhura me nenin 5 të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” si dhe në përcaktimet e pikës 3 shkronja “ç”, Kreu III dhe pikave 10, 11, 12 e 13 të Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, ka miratuar rezultatit të verifikimit të subjektit vetëdeklarues z. *Erin Pjeter Gjoni*, sipas të cilit konstatohet si më poshtë:

- Nuk rezulton të ketë gjeneralitete të tjera në përbërësit e gjendjes civile, përvec atyre të deklaruara në formular;
- Rezulton të jetë dënuar:

1. Me vendimin penal nr. 74 datë 01.03.2010, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, e cila ka vendosur “Deklarimin fajtor të të pandehurit Erin Pjeter Gjoni, për kryerjen e veprës penale të “Falsifikimit të dokumentave”, parashikuar nga neni 186/1 të Kodit Penal, duke e dënuar me 3 muaj burgim dhe 200.000(dyqynd mijë)lek gjobë. Deklarimin fajtor të të pandehurit Erin Pjeter Gjoni, për veprën penale “Drejtimit automjeti pa dëshmi”, parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal dhe dënimin me 50.000(pesëdhjetë mijë)lekë gjobë. Në aplikim të nenit 55/1 të Kodit Penal dënohet me 3 muaj burgim dhe 200.000 lek gjobë. Në aplikim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale dënohet përfundimisht me 2 muaj burgim dhe 140.000 (njëqind e dyzet mijë lek)gjobë. Në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënien në provë të të pandehurit Erin Pjeter Gjoni për një afat 2 vjecar.

2. Me vendimin nr. 345., datë 27.09.2011, i shpallur nga Gjykata e Alba, Itali sipas të cilit shtetasi shqiptar Erin Pjeter Gjoni, është dënuar për veprën penale të “Armbajtjes” në shtetin Italian vepër penale e parashikuar në bazë të neneve 582 dhe 558 të Kodit Penal, pasi duke

goditur me thikë ka shkaktuar lëndime personale shtetasit M.E (plagë me thikë në gjoks), gjykuar si plagë e shërueshme brenda dhjetë ditësh, por që është me rrethanë rënduese fakti që plagosja është kryer në përdorimin e armës. Në Bra 18.07.2011, duke vendosur dënimin e tij me tre muaj burgim, që ekzekutimi i vendimit të dhënë të mbetet i pezulluar në kuptim të nenit 163 dhe vijues të Kodit Penal për një periudhë prej pesë vjetësh.

3. Me vendimin penal të formës së prerë me nr. 833/2015., datë 10 dhjetor 2015, të Gjykatës së Apelit Një Anëtarëshe Patra Greqi, **është dënuar me dy (2) vjet burgim dhe dënimin monetar 1000 (njëmijë) euro, për “ Transport të paligjshëm në bashkëpunim”** në përputhje me nenet 1,12,14,16,17,18,26/1/a,47/1, 51,52,57,60,79 dhe 83 të Kodit Penal, dhe neneve 88/2 -1 a të Ligjit 3386/2005, siç u zëvendësua nga neni 48/4 i Ligjit 3772/2009, duke e pezulluar ekzekutimin e këtij vendimi për tre (3) vjet.

- Nuk rezulton të jetë dënuar ndonjëherë me vendim gjyqësor jopërfundimtar nga një autoritet gjyqësor shqiptar, për një çështje penale të pazgjidhur me vendim gjyqësor të formës së prerë;
- Rezulton të ketë qënë në hetim dhe gjykim nga autoritete të huaja ligjzbatuese dhe konkretisht:

1. Ka qënë në hetim nga Prokuroria pranë Gjykatës Alba, Seksioni i Veçuar në Bra, për ngjarjen e datës 18.07.2011, akuzuar se ka goditur me thikë dhe ka shkaktuar dëmtime personale sipas nenit 582 dhe 285 të Kodit Penal.Çështja është dërguar për gjykim.
2. Ka qënë në hetim nga Prokuroria e Shkallës së Parë Patra për ngjarjen e datës 24.04.2012, akuzuar për “Transport të Paligjshëm në bashkëpunim”, parashikuar nga nenet 1,12,14,16,17,18,26/1/a, 47/1,51,52,57,60,79 dhe 83 të Kodit Penal dhe neneve 88/2-1a të Ligjit 3386/2005, siç u zëvendësua nga neni 48/4 i Ligjit 3772/2009.Çështja është dërguar për gjykim.
3. Është kallëzuar penalisht në Prokurorinë Themelore të Shtetit Herceg-Novi, për fallsifikim dokumenti, parashikuar nga neni 412/2/1 i Kodit Penal dhe Prokuroria ka hedhur poshtë kallëzimin pasi i kallëzuari përmbushi detyrimin e caktuar me Vendimin e Prokurorisë Themelore të Shtetit Herceg -Novi, në bazë të nenit 272/1 pika 3 e Kodit të Proçedurës Penale Kt.(O) nr.263/2017, datë 09.12.2017.

Rezulton të jetë arrestuar:

1. Më datë 18.07.2011, nga autoritetet ligjzbatuese në Republikën e Italisë.
 2. Më datë 24.04.2012, nga autoritetet ligjzbatuese të Republikës së Greqisë.
- Nuk rezulton që ndaj tij të jetë caktuar ndonjëherë masë shtrënguese e sigurisë personale;
 - Nuk rezulton të jetë lëshuar ndonjëherë ndaj këtij personi një urdhër kërkimi ndërkombëtar lidhur me kryerjen e veprave penale;

III.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit dhe rezultatit të verifikimit të thelluar, të Prokurorit të Përgjithshëm konstaton se:

Nga shqyrtimi i rezultatit të verifikimit të Prokurorisë së Përgjithshme, rezulton se z. **Erin Pjeter Gjoni**, në bazë të vendimit penal të formës së prerë me nr. 833/2015., datë 10 dhjetor 2015, të Gjykatës së Apelit Një Anëtarëshe Patra Greqi, është dënuar me dy (2) vjet burgim dhe dënimin monetar 1000 (njëmijë) euro, për “Transport të paligjshëm në bashkëpunim “ në përputhje me nenet 1,12,14,16,17,18,26/1/a,47/1, 51,52,57,60,79 dhe 83 të Kodit Penal dhe neneve 88/2 -1a të Ligjit 3386/2025, siç u zëvendësua nga neni 48/4 i Ligjit 3772/2009, duke e pezulluar ekzekutimin e këtij vendimi për tre (3 vjet).

Referuar germës c, të pikës 1 të nenit 2, të ligjit nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", ndalimet për kandidimin, zgjedhjen apo ushtrimin e funksionit zbatohen ndaj personave të cilët janë dënuar me burgim me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi***kur janë dënuar me jo më pak së 2 vjet burgim.***

Në nenin 4 të ligjit nr.138/2025 citohet se: Për personat që parashikohen nga shkronja “c”, e pikës 1, të nenit 2, të këtij ligji, ndalimi për kandidim, zgjedhje apo ushtrim të funksionit zgjat 10 vjet nga momenti i përfundimit të dënimit me burg, sipas vendimit gjyqësor të formës së prerë.

Referuar shqyrtimit të rezultatit të verifikimit të Prokurorisë së Përgjithshme bazuar në germën c, pika 1, neni 2 i ligjit 138/2015, z. Erin Pjeter Gjoni, anëtar në Këshillin e Bashkisë Lezhë, i propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Social Demokrate” është në kushtet e ndalimit të ushtrimit të funksionit.

Në nenin 10, pika 1, shkronja “d”, të Ligjit nr. 138/2015, përcaktohet se KQZ “shpall pavlefshmërinë e mandatit dhe përfundimin e parakohshëm të mandatit kur kushtet e moskandidimit dhe moszgjedhshmërisë verifikohen pas fillimit të ushtrimit të mandatit nga personi përkatës, si dhe shpall mandatin në përputhje me këtë Kod, si dhe njofton Kryetarin e Kuvendit, në rastin e pavlefshmërisë së mandatit të deputetit, apo Kryeministrin, në rastin e kryetarit të bashkisë apo të këshilltarit bashkiak.

Sipas përcaktimit të këtij neni, KQZ është organi kompetent për shqyrtimin e vlefshmërisë së mandatit të një anëtari në këshillin e bashkisë. Ligji i dekriminalizimit, apo më mirë të themi bazuar në këtë ligj një personi i hiqet mandati i fituar (si deputet, kryetar bashkie, **anëtarë këshilli bashkiak**, apo ministër jo deputet) kur pas marrjes së këtij mandati, apo pas fillimit të

ushtrimit të detyrës, verifikohet se ai/ajo ka kryer një nga veprat penale të listuara nga Ligji i Dekriminalizimit.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 14. datë 2.2.2024, ka vendosur plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Lezhë, me kandidatin nga lista shumemërore të “Partisë Socialdemokrate,” z. Erin Pjeter Gjoni.

Nga shqyrtimi i rezultatit të verifikimit të Prokurorisë së Përgjithshme, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, vlerëson se anëtari në këshillin e bashkisë Lezhë, z. Erin Pjeter Gjoni, referuar nenit 2 pikës 1, shkronjës “c” dhe nenit 4, pika 3 e ligjit 138/2015, Kreut III të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, është në kushtet e ndalimit të ushtrimit të funksionit publik të anëtarit në këshillin e bashkisë Lezhë.

Licela VELIU	-Drejtorja e Subjekteve Zgjedhore, Mbikëqyrjes Financimit dhe Monitorimit
Pavlina DOÇAJ	- Drejtorja e Ligjshmërisë
Majlinda ÇELMETA	-Sekretar i Përgjithshëm (në mungesë dhe me urdhër)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 00.00.2025

Nr:

Ora: 00.00

VENDIM

PËR

SHQYRTIMIN E REZULTATIT TË VERIFIKIMIT TË PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM PËR SUBJEKTIN VETËDEKLARUES Z. ERIN PJETER GJONI, ANËTAR NË KËSHILLIN E BASHKISË LEZHË, I PROPOZUAR NGA SUBJEKTI ZGJEDHOR “PARTIA SOCIALDEMOKRATE”, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023

Sot më datë 00.01.2025, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në seancë publike shqyrtova çështjen me:

Objekt: Shqyrtimi i rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues z. Erin Pjeter Gjoni, anëtar në Këshillin e Bashkisë Lezhë, i propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Social Demokrate”, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Palë të interesuara: Z. Erin Pjeter Gjoni, anëtar në Këshillin e Bashkisë Lezhë, i propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialdemokrate”, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

Baza ligjore: Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, neni 90 i ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, të ndryshuar, neni 2, pika 1 germës “(c),” dhe neni 4, pika 3 të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pikat 12, 13, 14, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr.

138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike””.

Në përfundim të shqyrtimit administrativ,

VËREJ:

I.

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin për funksionet publike si dhe përpunimin për formularin e vetëdeklarimit për disa subjekte ndër të cilat është edhe “Anëtari në Këshillin e Bashkisë”.

Z. Erin Pjeter Gjoni, është propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialdemokrate” si kandidat për anëtar në Këshillin e Bashkisë Lezhë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

Për këtë kandidat më datë 19.3.2023, pranë KQZ është depozituar formulari i vetëdeklarimit i cili është regjistruar me nr. unik LE-PSD 4943. Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të z. Erin Pjeter Gjoni, rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015.

Në kuadër të verifikimit paraprak të kushteve të kandidimit të këtij kandidati, sipas përcaktimit të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, si dhe vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit:

- a) Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, nëpërmjet komunikimit në rrugë elektronike, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, e cila nga ana e saj informon Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, se subjekti vetëdeklarues z. Erin Pjeter Gjoni, rezulton të jetë i rehabilituar në bazë të nenit 69 të Kodit Penal.
- b) Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, nëpërmjet komunikimit në rrugë elektronike, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile, e cila nga ana e saj informon Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, se subjekti vetëdeklarues z. Erin Pjeter Gjoni, nuk ka ndryshime në përbërësit e gjendjes civile.

II

Pasi është konstatuar që kandidati nuk është në kushtet e ndalimit për të kandiduar, janë verifikuar të dhëna të tjera në formularin e vetëdeklarimit të z. Erin Pjeter Gjoni, ku rezultoi se ka deklaruar:

- Në rubrikën III. “TË DHËNA MBI GJENDJEN GJYQËSORE TË PERSONIT”, të Formularit të Vetëdeklarimit,
- Pyetjes I “A jeni dënuar ndonjëherë me vendim gjyqësor të formës së prerë nga një autoritet

- gjqësor shqiptar ose i huaj?” subjekti i vetëdeklarimit është përgjigjur “PO”, 1. Gjykata Shkodër me vendimin nr. 74, datë 01.03.2010 e ka dënuar me 2 (dy) vite shërbim prove për veprën penale të parashikuar nga neni 186/1 dhe 291,
2. Alba, Itali me vendimin nr. 345/11, datë 27.09.2011, ka vendosur pezullim burgimi për veprën penale të parashikuar në nenin 163 SS CP,
3. Në Malin e Zi është dënuar me gjobë 300(treqind) euro në Dhjetor 2017, pa përcaktuar veprën penale;
- *Pyetjes 3* “A keni qenë ndonjëherë në hetim ose gjykim nga një autoritet i huaj, për kryerjen e një vepre penale?” subjekti i vetëdeklarimit është përgjigjur “PO”,
 1. Prokuroria Alba Itali, në shtator 2011, dënuar me pezullim burgimi,
 2. Prokuroria Mal i Zi, në dhjetor 2017, dënuar me gjobë 300(treqind) euro;
 - *Pyetjes 4* “ A keni qenë ndonjëherë i ndaluar apo i arrestuar nga organet ligjzbatuese, për kryerjen e një vepre penale?” subjekti i vetëdeklarimit është përgjigjur “PO”
 1. Prokuroria Shkodër në vitin 2011, i dyshuar për veprën penale të parashikuar nga neni 186/1 dhe 291,
 2. Prokuroria Alba, në Bra Itali në korrik 2011, i dyshuar për ngatërrësë,
 3. Policia kufitare Malin e Zi në Dhjetor 2017, i dyshuar për vulë fallco;
 - *Pyetjes 8* “A keni jetuar ndonjëherë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për më shumë se 1 muaj?”, subjekti i vetëdeklarimit është përgjigjur “PO”; Subjekti vetëdeklarues ka qenë emigrant në Cuneo, Itali në vitin 2011.

Nga konstatimet e mësipërme Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me shkresën nr.4998., datë 11.05.2023, vendosi t’ia kalojë rastin për verifikim të thelluar Prokurorisë së Përgjithshme, si institucioni kompetent që kryen verifikimin e plotë të deklarimeve të bëra.

Me shkresën nr. 612/41 prot.extra 23, datë 11.09.2024, Drejtoria e Koordinimit Institucional, Sektori i Dekriminalizimit pranë Prokurorisë së Përgjithshme, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, vendimin “*Për miratimin e rezultatit të verifikimit për subjektin z. Erin Pjeter Gjoni*”, Prokuroria e Përgjithshme, pas kryerjes së gjithë verifikimeve përkatëse, i konsideron këto të fundit të plota dhe të bazuara në nenin 8, pikat 1 dhe 2, të lidhura me nenin 5 të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” si dhe në përcaktimet e pikës 3 shkronja “ç”, Kreu III dhe pikave 10, 11, 12 e 13 të Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, ka miratuar rezultatit e verifikimit të subjektit vetëdeklarues z. *Erin Pjeter Gjoni*, sipas të cilit konstatohet si më poshtë:

- Nuk rezulton të ketë gjeneralitete të tjera në përbërësit e gjendjes civile, përveç atyre të deklaruara në formular;
- Rezulton të jetë dënuar:

1. Me vendimin penal nr. 74 datë 01.03.2010, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, e cila ka vendosur “Deklarimin fajtor të të pandehurit Erin Pjeter Gjoni, për kryerjen e veprës penale të “Falsifikimit të Dokumentave”, parashikuar nga neni 186/1 të Kodit Penal, duke e dënuar me 3 muaj burgim dhe 200.000 (dyqynd mijë)lek gjobë. Deklarimin fajtor të të pandehurit Erin Pjeter Gjoni, për veprën penale “Drejtim automjeti pa dëshmi”, parashikuar nga neni 291, i Kodit Penal dhe dënimin me 50.000(pesëdhjetë mijë) lekë gjobë. Në aplikim të nenit 55/1 të Kodit Penal dënohet me 3 muaj burgim dhe 200.000 lek gjobë. Në aplikim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale dënohet përfundimisht me 2 muaj burgim dhe 140.000 (njëqind e dyzet mijë lek) gjobë. Në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim dhe vënien në provë të të pandehurit Erin Pjeter Gjoni për një afat 2 vjeçar.

2. Me vendimin nr. 345., datë 27.09.2011, i shpallur nga Gjykata e Alba, Itali sipas të cilit shtetasi shqiptar Erin Pjeter Gjoni, është dënuar për veprën penale të “Armbajtjes” në shtetin Italian veprë penale e parashikuar në bazë të neneve 582 dhe 558 të Kodit Penal, pasi duke goditur me thikë i ka shkaktuar lëndime personale shtetasit M.E (plagë me thikë në gjoks), gjykuar si plagë e shërueshme brenda dhjetë ditësh, por që është me rrethanë rënduese fakti që plagosja është kryer në përdorimin e armës. Në Bra 18.07.2011, duke vendosur dënimin e tij me tre muaj burgim, që ekzekutimi i vendimit të dhënë të mbetet i pezulluar në kuptim të nenit 163 dhe vijues të Kodit Penal për një periudhë prej pesë vjetësh.

3. Me vendimin penal të formës së prerë me nr. 833/2015., datë 10 dhjetor 2015, të Gjykatës së Apelit Një Anëtarëshe Patra Greqi, **është dënuar me dy (2) vjet burgim dhe dënimin monetar 1000 (njëmijë) euro**, për “ Transport të paligjshëm në bashkëpunim” në përputhje me nenet 1,12,14,16,17,18,26/1/a,47/1, 51,52,57,60,79 dhe 83 të Kodit Penal, dhe neneve 88/2 -1 a të Ligjit 3386/2005, siç u zëvendësua nga neni 48/4 i Ligjit 3772/2009, duke e pezulluar ekzekutimin e këtij vendimi për tre (3) vjet.

- Nuk rezulton të jetë dënuar ndonjëherë me vendim gjyqësor jopërfundimtar nga një autoritet gjyqësor shqiptar, për një çështje penale të pazgjidhur me vendim gjyqësor të formës së prerë;
- Rezulton të ketë qënë në hetim dhe gjykim nga autoritete të huaja ligjzbatuese dhe konkretisht:

1. Ka qënë në hetim nga Prokuroria pranë Gjykatës Alba, Seksioni i Veçuar në Bra, për ngjarjen e datës 18.07.2011, akuzuar se ka goditur me thikë dhe ka shkaktuar dëmtime personale sipas nenit 582 dhe 285 të Kodit Penal. Çështja është dërguar për gjykim.
2. Ka qënë në hetim nga Prokuroria e Shkallës së Parë Patra për ngjarjen e datës 24.04.2012, akuzuar për “Transport të Paligjshëm në bashkëpunim”, parashikuar nga nenet 1,12,14,16,17,18,26/1/a, 47/1,51,52,57,60,79 dhe 83 të Kodit Penal dhe neneve 88/2-1a të Ligjit 3386/2005, siç u zëvendësua nga neni 48/4 i Ligjit 3772/2009. Çështja është dërguar për gjykim.
3. Është kallëzuar penalisht në Prokurorinë Themelore të Shtetit Herceg-Novii, për falsifikim dokumenti, parashikuar nga neni 412/2/1 i Kodit Penal dhe Prokuroria ka

hedhur poshtë kallëzimin pasi i kallëzuari përmbushi detyrimin e caktuar me Vendimin e Prokurorisë Themelore të Shtetit Herceg -Novi, në bazë të nenit 272/1 pika 3 e Kodit të Proçedurës Penale Kt.(O) nr.263/2017, datë 09.12.2017.

Rezultoni të jetë arrestuar:

1. Më datë 18.07.2011, nga autoritetet ligjzbatuese në Republikën e Italisë.
 2. Më datë 24.04.2012, nga autoritetet ligjzbatuese të Republikës së Greqisë.
- Nuk rezultoni që ndaj tij të jetë caktuar ndonjëherë masë shtrënguese e sigurisë personale;
 - Nuk rezultoni të jetë lëshuar ndonjëherë ndaj këtij personi një urdhër kërkimi ndërkombëtar lidhur me kryerjen e veprave penale;

III.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit dhe rezultatit të verifikimit të thelluar, të Prokurorit të Përgjithshëm konstaton se:

Nga shqyrtimi i rezultatit të verifikimit të Prokurorisë së Përgjithshme, rezultoni se z. **Erin Pjeter Gjoni**, në bazë të vendimit penal të formës së prerë me nr. 833/2015., datë 10 dhjetor 2015, të Gjykatës së Apelit Një Anëtarëshe Patra Greqi, është dënuar me dy (2) vjet burgim dhe dënimin monetar 1000 (njëmijë) euro, për “Transport të paligjishëm në bashkëpunim “ në përputhje me nenet 1,12,14,16,17,18,26/1/a,47/1, 51,52,57,60,79 dhe 83 të Kodit Penal dhe neneve 88/2 -1a të Ligjit 3386/2025, siç u zëvendësua nga neni 48/4 i Ligjit 3772/2009, duke e pezulluar ekzekutimin e këtij vendimi për tre (3) vjet).

Referuar germës c, të pikës 1 të nenit 2, të ligjit nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", ndalimet për kandidimin, zgjedhjen apo ushtrimin e funksionit zbatohen ndaj personave të cilët janë dënuar me burgim me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi ...***kur janë dënuar me jo më pak se 2 vjet burgim.***

Në nenin 4 të ligjit nr.138/2025 citohet se: Për personat që parashikohen nga shkronja “c”, e pikës 1, të nenit 2, të këtij ligji, ndalimi për kandidim, zgjedhje apo ushtrim të funksionit zgjat 10 vjet nga momenti i përfundimit të dënimit me burg, sipas vendimit gjyqësor të formës së prerë.

Referuar shqyrtimit të rezultatit të verifikimit të Prokurorisë së Përgjithshme bazuar në germën c, pika 1, neni 2 i ligjit 138/2015, z. Erin Pjeter Gjoni, anëtar në Këshillin e Bashkisë Lezhë, i propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Social Demokrate”, është në kushtet e ndalimit të ushtrimit të funksionit.

Në nenin 10, pika 1, shkronja “d”, të Ligjit nr. 138/2015, përcaktohet se KQZ “shpall pavlefshmërinë e mandatit dhe përfundimin e parakohshëm të mandatit kur kushtet e moskandidimit dhe moszgjedhshmërisë verifikohen pas fillimit të ushtrimit të mandatit nga personi përkatës, si dhe shpall mandatin në përputhje me këtë Kod, si dhe njofton Kryetarin e Kuvendit, në rastin e pavlefshmërisë së mandatit të deputetit, apo Kryeministrin, në rastin e kryetarit të bashkisë apo të këshilltarit bashkiak.

Sipas përcaktimit të këtij neni, KQZ është organi kompetent për shqyrtimin e vlefshmërisë së mandatit të një anëtari në këshillin e bashkisë. Ligji i dekriminalizimit, apo më mirë të themi bazuar në këtë ligj një personi i hiqet mandati i fituar (si deputet, kryetar bashkie, **anëtarë këshilli bashkiak**, apo ministër jo deputet) kur pas marrjes së këtij mandati, apo pas fillimit të ushtrimit të detyrës, verifikohet se ai/ajo ka kryer një nga veprat penale të listuara nga Ligji i Dekriminalizimit.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 14. datë 2.2.2024, ka vendosur plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Lezhë, me kandidatin nga lista shumemërore të subjektit zgjedhor “Partisë Socialdemokrate,” z. Erin Pjeter Gjoni.

Nga shqyrtimi i rezultatit të verifikimit të Prokurorisë së Përgjithshme, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, vlerëson se anëtari në këshillin e bashkisë Lezhë, z. Erin Pjeter Gjoni, referuar nenit 2 pikës 1, shkronjës “c” dhe nenit 4, pika 3 e ligjit 138/2015, Kreut III të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, është në kushtet e ndalimit të ushtrimit të funksionit publik të anëtarit në këshillin e bashkisë Lezhë.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronja “n” e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, neni 90 i ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, të ndryshuar, neni 2, pika 1 gërmës “(c),” dhe neni 4, pika 3 të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pikat 12 13 14 të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”

V E N D O S :

1. Të shpallë të pavlefshëm dhe përfundimin e parakohshëm të mandatit të anëtarit të Këshillit të Bashkisë Lezhë z. Erin Pjeter Gjoni, i propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialdemokrate”, për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Illirjan CELIBASHI